Kronikë

# Sherr me shkopinj bejsbolli mes të rinjve në Tiranë, njëri qëllon me armë në ajër! 4 në kërkim

*5 të rinj u përfshinë në një sherr me shkopinj bejsbolli në zonën e Ali Demit në Tiranë. Njëri u plagos dhe përfundoi në spital. Policia sekuestroi shkop bejsbolli, 2 gëzhoja, 1 automjet dhe 3 celularë.*




*Policia e Tiranës*

Redaksia
11 Qershor, 09:38 | **Përditesimi: 11 Qershor, 11:02**

Share

**TIRANË-** Një sherr mes të rinjve ka degraduar deri në përdorimin e shkopinjve të bejsbollit. Ngjarja ka ndodhur mbrëmjen e 10 qershorit rreth orës 23:00 në zonën e Ali Demit në Tiranë, ku 5 të rinj janë konfliktuar mes njëri-tjetrit, pas një borxhi të pashlyer.

Gjatë sherrit, njëri prej të rinjve dyshohet se ka qëlluar me armë zjarri në ajër. Një 26-vjeçar, G.K ka mbetur i plagosur dhe wshtë dërguar për të marrë ndihmë mjekësore në spital dhe tani ndodhet jashtë rrezikut për jetën.

4 të rinjtë e tjerë që ishin përfshirë në sherr janë identifikuar dhe shpallur në kërkim nga policia. Ndërkohë, 26-vjeçari sipas bluve të Tiranës ka dhënë dëshmi kontradiktore për ngjarjen dhe policia thotë se do kryejnë veprimet procedurale në vijim.



LEXO EDHE:
**'Pse flet për familjen tonë'/ Babë e bir e dhunuan me grushta, 60-vjeçari godet me kaçavidë të riun në Patos**

Gjatë kryerjes së vendit të ngjarjes janë gjetur dhe sekuestruar 1 shkop bejsbolli, 2 gëzhoja, 1 automjet dhe 3 celularë.

> *"Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Nr. 1 shpallën në kërkim shtetasit F. D., 36 vjeç, D. Zh., 25 vjeç, M. D., 27 vjeç dhe F. S., 27 vjeç, pasi mbrëmë, rreth orës 23:00, në rrugën "Ali Demi", dyshohet se janë konfliktuar fizikisht dhe me sende të forta, me njëri-tjetrin. Si pasojë është dëmtuar shtetasi G. K., 26 vjeç (i dyshuar i përfshirë në konflikt), i cili mori ndihmën mjekësore dhe është jashtë rrezikut për jetën. Me 26-vjeçarin do të kryhen veprime procedurale në vijim, pasi ka deklaruar të dhëna kontradiktore për ngjarjen. Nga veprimet e para hetimore dyshohet se gjatë konfiktit është qëlluar me armë zjarri në ajër. Gjatë kryerjes së vendit të ngjarjes janë gjetur dhe sekuestruar 1 shkop bejsbolli, 2 gëzhoja, 1 automjet dhe 3 celularë. Vijon puna për kapjen e shtetasve në kërkim dhe për dokumentimin e plotë të rrethanave të ngjarjes", njoftoi policia e Tiranës.*

Xh.D/SI.E./Shqiptarja.com

TAG: Tirane | policia e tiranes | sherr | te shtena me arme

**Komente**

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

**Sondazhi i ditës:** 11 Qershor, 23:51

**Jeni dakord me kërkesën e gjyqtarëve për rritje të pagës me 700 euro?**

Po | Jo | Nuk e di

## Lajme të tjera



Rikonstruktimi i rrugës Tiranë-Ndroq! Realizohen 38% e punimeve
12 Qershor, 12:40



Kërkuan rinumërimin e votave të tyre, Kolegji Zgjedhor rrëzon ankimimin e Alimehmetit, Kalasë dhe Kuçanës, shtyhet seanca për Shehun! Shkak mungesa e tij
12 Qershor, 10:58




Tiranë/ Iu gjet armë në makinë, arrestohet 28-vjeçari! 2 të tjerë në kërkim (VIDEO)
12 Qershor, 09:36



Vrau me thikë kushëririn në Klos, 32-vjeçari arrestohet në Tiranë, dyshohet për motive pronësie! Vajza e viktimës kërkon drejtësi: S'ja falim gjakun
12 Qershor, 07:50



Publikimi i videos së vrasjes së Martin Canit, Prokuroria e Tiranës regjistron procedim penal për zbulimin e të dhënave sekrete
11 Qershor, 18:57



Gjyqi për vrasjen e Martin Canit, dëshmojnë 6 persona, seanca me dyer të mbyllura, e radhës më 25 qershor
Keti Banushi
11 Qershor, 15:59



'Rikuperimi' i ish-bllokut, në korrik nis projekti! Këmbësorëve u kthehet hapësira e 'vjedhur' nga korsitë e parkimit
Blerina Goce
11 Qershor, 15:37




Tentoi të vidhte në një automjet, arrestohet 36-vjeçari në Kavajë! Në kërkim pronari i makinës
11 Qershor, 12:40




Fier/ Goditi të riun me levë dhe e kërcënoi me pistoletë, arrestohet 48-vjeçari
11 Qershor, 11:38



Bashkia e Tiranës miraton 1100 kredi të buta për familjet dhe çiftet e reja
10 Qershor, 19:20




Hapet konkurrimi për drejtues në disa komisariate, priten edhe ndryshime për shefa krimesh
10 Qershor, 18:58



IMT i konsideron të paligjshme, hiqen të gjitha strukturat e jashtme të bizneseve në stadiumin Air Albania
10 Qershor, 18:29




RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com



© 2011 - 2025 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje